

V E N D I M
Nr. 600, datë 17.11.2000

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.529, DATË 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE
QË ZOTËROHEN NGA SHTETI, TË SHOQËRIVE TREGTARE”, NDRYSHUAR ME AKTE
TË TJERA LIGJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë“, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave në kapitullin XI, pas pikës 3, shtohet pika 3.1. me këtë përmbajtje:

“3.1. Në rastet kur blerësi kërkon që të bëhet auditim ndërkombëtar, për gjendjen e shoqërisë, afati i mbylljes së kontratës shtyhet 45 ditë të tjera.

Ky afat aplikohet edhe për kontratat të cilat janë në proces negociimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta